

Ermonela Jaho është soprano shqiptare me famë botërore. Lindi në Tiranë, në vitin 1974. U largua në vitin 1993 nga Shqipëria për në Itali me një bursë studimi, dhe më pas iu desh ta realizojë ëndrrën e ngjitjes në skenë, përkrah artistëve të huaj.

Pas përfundimit të studimeve për këndim dhe piano, ajo fitoi disa konkurse të rëndësishme, të tilla si: Giacomo Puccini në Milano Itali më 1997, Spontini International Ancona, Itali më 1998, në Rovereto Zandonai, Itali më 1999, këngëtarja më e mirë e Festivalin Wexford më 2000.

Ermonela Jaho filloi ta mësojë këngën në moshën 6 vjeçare. Pas diplomimit nga Liceu Artistik Jordan Misja, në Tiranë në 1992, ajo studion në Akademinë e Arteve po në Tiranë. Ajo fiton një konkurs të organizuar nga sopranoja italiane Katia Ricciarelli në Shqipëri, dhe vendoset në Itali ku fillon të studiojë në akademinë e Mantovës. Më pas, ajo ndjek studime muzikore në Akademinë Kombëtare të Santa Cecilia, në Romë.

Jaho fillon të interpretojë në skenë në Bolonja, në rolin e Mimit (*La Bohème* e Puçinit), në La Fenice, e më pas në rolin e Suzanës (Dasma e Figaros), si edhe në Trieste në rolin e Mikaelës (Karmen). Dalja e saj e parë në skenë jashtë Italisë ishte në festivalin e Wexfordit në Irlandë, ku këndoi operën *Safo* të Massenet, dhe *Vajza e Orleanit* të Çajkovskit. Në Gjermani, ajo shfaqet me rolin e Norinës (*Don Paskuale*) në Mynih. Më pas ajo interpreton përsëri Suzanën në Gjenevë dhe në Francë, në teatrin Kapitol të Tuluzës. Në Shtetet e Bashkuara, ajo paraqitet me Mimin, me Teatrin e Operës Michigan.

Nga viti 2009, karriera e saj e kthen atë në një ikonë arti botërore. Fitoi shpejt sukses nëpër botë, me lavdërime të shumta nga kritikët. Ajo vazhdon të paraqitet me *La rondine* të Puçinit në Trieste, *Karmen* në Glyndebourne dhe *La Traviata* në Lion. Në 2009, ajo vjen si Liù (*Turandot*) në Filadelfia, Vitellia (*La Clémence de Titus*) në Avinjon, dhe Ana Bolena në Paris.

Në tetor 2010, ajo duartrokitet në rolin kryesor Thaïs (e kompozitorit Zhyl Masene) në operën e Tulonit. Në prill 2011, ajo luan rolin e Luizës në *Luiza Miller* e Verdit në operën e Lionit, nën regjinë e David Alden.

Në tetor 2013, ajo këndon në *La Vestale* (Spontini) në Teatrin e Champs Élysées. Për hapjen e sezonit 2013/2014 në operën e Grand Avignon, ajo risjell rolin e Cio-Cio-San në *Madama Butterfly*, nën regjinë e Mireille Laroche.

Në shtator 2014, ajo shfaqet si Violeta e Traviatës në Operën Bastille, dhe në tetor vjen me një recitim në sallën Cortot të 'École Normale de Musique de Paris', e shoqëruar nga Genc Tukiçi.

Pasi risjell rolin kryesor të Madamës Butterfly në 2015, në janar 2016, ajo është Desdemona e Othellos (Verdi) në Teatrin e Madh të Liceut në Barcelonë.

Në shkurt 2017, ajo vjen përsëri si Violeta e *Traviatës* në Sydney Opera House, ku vlerësohet fort në krah të José Carbó (Giorgio Germont) dhe Ho-Yoon Chung (Alfredo Germont).

Çmime

Ermonela Jaho ka fituar një sërë konkursesh ndërkombëtare:

- 1997: *Giacomo Puccini* në Milano
- 1998: *Spontini* në Ankona
- 1999: *Zandonai* në Rovereto

- 2000: Çmimi i artistit më të mirë lirik në Festivalin e Weksfordit